



## QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORE

### KARTË – TEKNOLOGJIKE

#### PRODHIMI I FIDANËVE TË AGRUMEVE

##### **Mbjellja e farës:**

Koha: Muaji Dhjetor -15 Janar.

##### **Trajtimi i farës dhe mbjellja:**

Farat para mbjelljes trajtohen me sulfat hidroksinë 0.1% ose me Benlate 0.6 % për 5 sekonda. Farat ambalazhohen në qeskë polietileni me letër të lagur e të mbyllur, vendosen në frigorifer në temperaturë 7 °C, ku mbahen 4 muaj deri në 1 vit. Mund të mbillet në çdo kohë. Para mbjelljes, fara nxirret nga qeskat e vendoset në ujë të ëmbël dhe lihet për 12 orë. Shtrati: Përgatitet me dërrasa ose blloqe në përmasa nga 2m x 1m. Pasi nivelohet mirë mbushet me dherishte të përbërë nga dhe i pasur nga shtresa e I-rë të tokës+pleh i dekompozuar+torfë e mineralizuar+ agropërlit ose rërë e larë lumi (në raporte 1:1:1:1). Mbillet në shtrat ose edhe në vazeta të posaçme plastike të ngjitura nga 60 copë së bashku.

- Pas mbushjes së shtratit 75% me dherishte, ngjishet me një mallë dërrase, mbillet fara me rrjeshta në çdo 5 cm ose rrogoz në gjithë sipërfaqen e mbulohet me 2 cm dherishte.

- Në vazeta plastike mbillet 1 farë për çdo ndarje, duke bërë së pari një gropë me gishtin tregues të dorës, hidhet fara, mbulohet me dherishte, ngjishet me dorë e ujitën të gjitha së bashku apo veç e veç, me shoshonar apo sprucatorë.

- Farat në këtë shtrat apo në vazeta të vendosura në kushtet e serrës me mjergullim ose të një serre diellore, mbijnë pas 45-60 ditësh. Para mbirjes së farës se nënshartësive mbijnë shumë barëra konkurrues, të cilët largohen herë pas here. Ka raste të shfaqjes së simptomave të sëmundjes së *Kalbëzimit të qafës së rrënjës*, sidomos tek Nerënxa (*Phytophthora citrophthora*, sin. *Ph. parasitica* Dasteur).

- Është një sëmundje kërpudhore me një zhvillim shumë të shpejtë, ndaj duhet ndërhyrë menjëherë, duke ndërprerë ujitjen e duke bërë pluhurosje me Zineb pluhur, Zineb 80 lëng 0.3%, lëng bordolez 2%, apo të tjerë fungicide, në gjithë vendin e infektuar dhe të zonës përreth. Kjo sëmundje përsëritet shpesh e stimuluar nga lagështia, ndaj mbahet nën kontroll me vrojtime të vazhdueshme deri sa formohet çifti i parë i gjetheve të vërteta, koha më optimale për trapjantimin e parë të filizave.

**Trapjantimi i parë i filizave:** Kur fidani formon çiftin e parë të gjetheve të vërteta është i gatshëm për mbjellje në qesa a vazo plastike, të biruara nga poshtë, me përmasa 10 x 10 x 10 cm., me formë konike a rrethore të mbushura me dherishte perlit + torfë e mineralizuar + pleh organik i dekompozuar në raport 1:1:1. Para shkulljes së filizave nga shtrati bëhet një ujitje me ujë të bollshëm. Filizat shkullen me përzgjedhje të atyre më të rriturve që kanë prejardhje vegetative, grupohen në tufa 100-she dhe pasi u banjëzohen rrënjët në solucion bajgë lope 6% + Benlate 0.6% janë të gatshëm për trapjantimin e parë në vazo apo në qeskë polietileni. Ky operacion koinçidon me ditët e para të muajit Mars.

- Mbjellja e filizave në vazo apo qeskë është një ndër momentet më delikate për sigurimin e zënies e të zhvillimit normal të filizit të porsashkullur. Këshillohet që vazua apo edhe qeska, pasi të mbushen pak me

dherishte shtrihen pjerrtaz, vendoset filizi pa e përthyer e bëhet mbushja gradualisht me dherishte deri sa qeska mbushet plotësisht. Kthehet në pozicionin normal (vertikal) dhe bëhet një tërheqje e lehtë e filizit për të drejtuar trupin e tij. Në fund vazua a qeska kapet tek gryka, duke e sistemuar me levizje të lehta 2-3 herë për tokë. Ky veprim bën kontaktin e plotë të rrënjës me dherishten.

- Më pas vazot apo qeskat radhiten brenda një serre rrjetë per 4 deri 6 së bashku, në gjithë gjatësinë e mundëshme e ujiten me potisierë ose sprucatorë. Midis këtyre rreshtave lihet një rrugicë 0.5 m., për të kaluar punëtori i shërbimit dhe më pas shartuesi. Temperatura nuk duhet të kalojë 28 °C dhe lagështia ajrore të ruhet në kufijtë 75 - 80%. Deri në muajin maj filizat arrijnë të mbushin me rrënjë volumin e vazos dhe janë të gatshëm për trapiantimin e II në qeskat apo vazot definitive.

**Trapiantimi i dytë i filizave të rritur në vazo:** Bëhet duke e nxjerrë filizin me gjithë bukën e dheut nga vazua dhe duke e vendosur atë në mesin e një vazojë më të madhe apo një qeskë polietileni me përmasa 20 x 20 x 30 të mbushur përgjysëm me dherishte të përgatitur nga dhe i shtresës së parë të tokës + torfë + pleh i dekompozuar + perlit, në raport 1:1:1:1. Më pas mbushen gjithë anët e filizit me dherishte tjetër, derisa mbushet plotësisht qeska apo vazua, ujiten me ujë të bollshëm e radhiten në vendin e caktuar për rritje (fidanishte)

**Shërbimet në fidanishte:** Janë të domosdoshme e të pa tolerueshme për çdo ditë të vitit. Punohet kryesisht me heqjen e sqetullorëve, pastrimin e gjëmbave, ujitjen e rregullt, spërkatjet në rast rënie të sëmundjes apo dëmtuesit dhe plehrimin suplementar me plehra azotike apo me plehra të kombinuar, për të stimuluar rritjen e zhvillimin normal të filizit. Me shërbime intensive dhe në kushtet e një serre rrjetë për hijezim, ku temperatura rregjistrohet e mbahet vazhdimisht 24 - 26 °C gjatë muajve të verës, filizi arrin standartin për shartim 1 vit pas mbjelljes së tij në qeskë apo vazo definitive. Synimi është që dherishtja gjithmonë të jetë e pastër nga barnat konkurrues, e ujitur dhe e shkrihet, të ruajë lagështinë dhe oksigjenin e nevojshëm për mykorizat.

Herë pas here bëhen shkrihetime të dherishtes në qeskë, plehrime suplementare me 5 gr nitrat amoni/qeskë dhe pastrimi i thithakëve e gjëmbave që dalin në trupin e filizit, deri 15 cm tek nënshartesat gjetherënëse (Trifoliatë e Rubidoux), deri 45 cm. Tek nënshartesat Nerënxë, limon Volkameria e hibridet e tregjethëshit (Citrangët). Kur filizi arrin trashësinë 5-6 mm në lartësinë e rekomanduar për shartim për çdo nënshartesë dhe lëkura ndahet lehtësisht nga druri, ai është i gatshëm për shartim.

**Shartimi i agrumeve:** Bëhet nga mjeshtër me përvojë që dallojnë lehtësisht momentin e kryerjes së këtij operacioni tepër delikat në kushtet e rritjes në mjedis të hapur. Kalamat për shartim merren nga bimët “mëmë”, 1 vjeçarë, të pjekur, pa brinjëzime, pa gjemba, u priten gjethet tek nyja e bishtit, vendosen në qeskë polietileni dhe ruhen në kuti frigoriferike.

- Për shartim zgjidhen kalema të rritjes I-rë vegjetative, të shëndetshëm, të pjekur, të saktë gjenetikiisht nga varieteti që dëshiron dhe të freskët (priten pas dite, shartohen paraditen e ditës tjetër). Për t’u përdorur më gjatë ambalazhohen me myshk të lagur. Është mirë që shartimi të kryhet brenda ditës nga ora 06-09 paradite e 17-19 mbasdite, në ditë pa erë e pa shi. Zgjidhen sytha të mesit të lastarit pa gjemba e brinjëzime.

Në vendin tonë praktikohen me sukses shartimi me syth të fjetur (15 Gusht-Shtator), dhe të zgjuar (15 Mars -15 Qershor, kur fillon lëvizja e lëngjeve), në formë të gërmës T. Lidhja me rrafje bëhet nga lart-poshtë dhe e zgjidhshme lehtësisht. Lidhës me rezultat zënie mbi 90% e pa nevojë zgjidhje pas verifikimit të zënies së shartimit është PLASTFILMI, i provuar edhe në Qendrën tonë.

Menjëherë pas shartimit bima etiketohet me etiketë, ku shkruhet Mbishartesa, Nënshartesa shkurtimisht p.sh T/N (Taroko/Nerënxë) dhe data e shartimit (15.03.2009).

Etiketa lidhet mbi gjethen e parë të nënshartesës sipër ndërnyjes ku është bërë shartimi.

Menjëherë pas shartimit bëhet reduktimi i kurorës së nënshartesës për të rritur furnizimin e vendit të shartuar me më shumë lëndë ushqyese. Zënia verifikohet pas 2-3 javësh.

Pas shartimit me syth të fjetur sythi i zënë çel në pranverë me ngritjen e temperaturës ajrore e rrënjore mbi

10 °C.

- Pas shartimit me syth të zgjuar sythi i zënë çel 5-10 ditë pas përkuljes dhe pas prerjes 1.5 cm mbi pikën e shartimit.
- Dy deri tre javë pas shartimit bëhet verifikimi i zënies, përthyerja në rast zënijeje e gjithë pjesës mbi pikën e shartimit dhe lirimi i rrafjes në rastet e mos përdorimit të plastfilmit. Sythi i zënë rrëzon bishtin e gjethes pasi e prek me gishtin tregues, ndërsa sythi i pa zënë nuk e rrëzon atë. Në rast moszënie sythi është i tharë e ka ngjyrë kafe të errët. Në të tilla raste, si rregull bëhet rishartimi me po të njëjtin kultivar një ndërnjësje më poshtë.
- Pas prerjes e çeljes së sythit bëhet përditë kontroll për eliminimin e thithakëve që çelin mbi dhe nën pikën e shartimit dhe për eliminimin e dubluesve apo trebluesve të lastarit kryesor të dalë nga sythi i çelë.
- Në kushtet e pakësimit të shpenzimeve për fuqi punëtore dhe shfrytëzim më të plotë të mbetjeve të plasmasit të zi, është praktikuar veshja e gjithë trungut të nënshartesës poshtë pikës së shartimit me plasmas të zi. Roli i tij kryesor është të mos lejojë çeljeje e thithakëve nga nënshartesa, por nga ana tjetër ai stimulon zhvillimin e kërpudhave dhe të breshkëzave në trung të bimës.
- Pas çeljes së sythit të përbërë, si rregull hiqen ata lastarë të mbishartesës që ndodhen më lart, për të mos hapur plagë poshtë sythit e ndërprerje të përkohëshme të gypave përçues të lëvres. Gjatë gjithë kohës trangu i nënshartesës pastrohet nga thithakët që çelin nga sythat e fjetur e të përbërë.
- Me zgjatjen e mbishartesës vendosen shufra individuale kallami, bëhet pincimi kur bima arrin mbi 60 cm lartësi për të nxitur formimin e kurorës me 3-4 degë skeletore.
- Bëhen plehrime suplementare gjatë verës me DAP 10-15 gr/queskë apo 15-20 gr Nitrat amoni të tretura në 10 litra ujë/10 m<sup>2</sup> sipërfaqe me qeska.
- Plehrimi i parë bëhet 10-15 ditë pas çeljes së filizit, i dyti 20-25 ditë më vonë. **Kujdes, të mos lagen gjethet gjatë plehrimit!** Për siguri, menjëherë pas plehrimit bëhet shpëlarja me ujë të rrjedhshëm. Gjatë pranverë-verës bëhen ujitje me shihedhje të përditëshme, pastrim barnash nga qeska çdo 3 ditë dhe spërkatje të përjavëshme kundër dëmtuesve.
- Ruajtja e fidanëve nga sëmundje kërpudhore e dëmtues si Breshkëza e kuqe, Tenja minuese, gjarpërore etj., bëhet me trajtimeve kimike me Confidor 20 LS 0,5%, Vermitex 0.2%, Agamin 0.25%, Actelic 0.1%, duke bërë alternimin e tyre çdo 10 ditë.
- Nga studimet e kryera në vende të tjera rekomandohet ujitje e shoqëruar me preparatin Confidor me dozë 0.05% dhe trajtim gjethor me Vertimex 0.03% çdo 20 ditë.
- \* Me përllogaritje për të prodhuar 5000 fidanë/vit duhet të punojnë çdo ditë të vitit me agrumet 3 punëtorë të përhershëm, të sigurohen kalemata në kohë nga bimë të çertifikuara dhe të përkujdeset një personel teknik.
- \* Me këtë teknologji fidani është i gatshëm për mbjellje në vendin e përhershëm 2.5 vjet pas mbjelljes së farës së Nerënxës dhe 2.8 vjet pas mbjelljes së farës së Trifoliatës.

**Standartet e fidanëve të agrumeve:** Konformë standarteve ndërkombëtare fidani i agrumeve duhet të jetë i shartuar mbi nënshartesë të përshtatëshme për kultivarin të jetë standart për mbjellje në vendin e përhershëm. Rëndësi për fidanin e ardhshëm ka lartësia e shartimit e cila është e ndryshme për nënshartesa të ndryshme. Edhe provat e kryera nga në këtë drejtim kanë vërtetuar parametrat e rekomanduara nga kërkues të shteteve të tjerë mesdhetarë.

Fidani ka arritur standartin për shitje kur në lartësinë 20-30 cm mbi pikën e shartimit ka 3-4 degë skeletore të gjata deri 25 cm, është i pastër nga sëmundjet virusale, ka ngjyrë të gjelbër intensive të gjethëve dhe është i pajisur me etiketë.

Specialist:  
Lida Lazaj